



Prishtinë, 29.01.2024
Kodi i ZRRE-së: V_1864_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Metodologjinë e Taksave të Kycjes të Rrjetit të Shpërndarjes;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2487_01_24** i dt.22.01.2024;

në seancën e mbajtur më datë 29.01.2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** ankesa e aplikuesit **F.S, N.T.P Fontana-FS** nga Komuna e Vitisë si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. KEDS** duhet të beje revidimin e Pëlqimit elektroenergjetik dhe Zgjidhjes Teknike nr. 4630 datë 26.05.2023 sipas kërkesës së Aplikuesit.
- III. Aplikuesi** duhet të dorëzoj në KEDS deklaratën e noterizuar me të cilën merr përgjegjësinë që pas dislokimit të pjesës së linjës 10 kV të bëjë kyçjen e TS sipas propozimit të tanishëm ose ardhshëm të dhënë nga KEDS.

A r s y e t i m

Aplikuesi **F.S N.T.P Fontana-FS** me datë 12.10.2023 ka paraqitur ankesë pranë DMK-së në ZRrE duke kontestuar përgjigjen e KEDS-it nr. 8191 datë 21.08.2023, me të cilën është refuzuar kërkesa e tij për ndryshim të kushteve teknike të dhëna me Pëlqimin Elektroenergjetik dhe Zgjidhjes Teknike të dhëna paraprakisht me PEE nr.4630 dt. 26.05.2023 dhe kanë mbetur në fuqi kushtet teknike të dhëna përmes PEE &ZT nr.4630 dt. 26.05.2023.

Investitori **F.S, N.T.P Fontana-FS** ka aplikuar për pëlqim elektroenergjetik në KEDS për objektin afarist si dhe ka dorëzuar projektin elektrik. Sipas përmbledhjes së projektit vërtetohet se kërkesa fuqi maksimale të njëkohshme për një njësi prej Pmnj=70 kW(sipas projektit elektrik)

Provë: Pëlqimi elektroenergjetik dhe Zgjidhja Teknike nr. 4630 datë 26.05.2023



Me datë 26.05.2023 KEDS ka lëshuar PEE dhe Zgjidhjen teknike nr. 4630 ku ka theksuar se: duke marre parasysh që dalja 10 kV "J03 Gërmova" me kod 61067003 nuk ka kapacitet për kyçjen trafostacionit tuaj të ri mirëpo është në planin investiv të KEDS-it për rritje të kapacitetit, ky Pëlqim Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike vlen në afat prej 365 ditësh kalendarike pasi ti bëhet rritja e kapaciteteve energjetike nga ana e KEDS. Pas këtij afati, nëse nuk ka Pranim Teknik, KEDS nuk është i obliguar të lëshoj Pëlqim me kushte të njëjta, fuqia e rezervuar për këtë PEE nuk do të garantohet.

Bazuar në të dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike është lëshuar për veprimtarin afariste:

Objekt afarist, 1 njësi, Fuqia e transformatorit $S_{int}=100$ kVA me fuqi maksimale të njëkohshme prej $P_{mnj}=70$ kW (sipas projektit elektrik). Në PEE dhe ZT po ashtu janë përcaktuar edhe kushtet teknike të kyçjes si dhe mënyrës së furnizimit të aplikuesit. Furnizimi i objektit me energji elektrike të bëhet nga LP 10(20)kV dalja "Dalja Gërmoves me kod: 61067003" prej NS 35/10kV "Rrafshina". Ekzekutimi i kyçjes së trafostacionit të ri të bëhet nga trafostacioni ekzistues TSSH 10/0.4 kV "Verban-te Sokoli" me kod 61067003044. Nga pika kyçëse e deri tek TS-i i ri të realizohet linja e re 10(20)kV për skaj rrugës publike sipas standardeve dhe projektit elektrik të aprovuar paraprakisht nga KEDS Departamenti i Investimeve. Trafostacioni i ri TS 10(20)/04 kV duhet të jetë me fuqi instaluese $S_n=100$ kVA i tipit "Trafo Shtyllë", me të gjitha pajisjet adekuate për këtë tip të trafostacionit dhe i ndërtuar në vend të përshtatshëm me mundësi të qasjes së përhershme...

Provë: Pëlqimi elektroenergjetik dhe Zgjidhja Teknike nr. 4630 datë 26.05.2023

Me datë 31.07.2023 Investitori **F.S**, ka parashtruar kërkesë në KEDS që të i bëhet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 4630 datë 26.05.2023. Aplikuesi në kërkesën e tij ka theksuar se përmes këtij pëlqimi me është lejuar kyçja në TSSH Nr:61067003044 me kabell nëntokësor në një gjatësi 550m deri të TSSH I Ri, andaj me mirëkuptim kërkojmë ndërrimin e pikës kyçjes pasi që rrjeti ajror 10 kV kalon shumë afër parcelës sonë. Parcela nga ku kërkojmë kyçjen në rrjetin 10kV të TSSH I Ri është prone e komunës andaj edhe kemi marr pëlqimin nga KK Viti për ndërtimin e L.P ajror në pronën e kësaj Komune.

Provë: Kërkesa e konsumatorit për revidim të Pëlqimit Elektroenergjetik dhe Zgjidhjes Teknike nr. 4630 datë 26.05.2023

Me datë 21.08.2023 KEDS përmes një përgjigje e refuzon kërkesën e palës për ndryshim të kushteve teknike të dhëna me PEE dhe Zgjidhjen Teknike nr.4630 dt. 26.05.2023, konkretisht mënyrën e kyçjes së trafostacionit tuaj është refuzuar dhe mbasin në fuqi kushtet teknike të dhëna në Pëlqimin Elektroenergjetik nr.4630 dt. 26.05.2023. Në arsyetimin e përgjigjes është theksuar se duke pas parasysh që dalja 10 kV "J03 Gërmova" me kod 61067003 nuk ka kapacitet për kyçjen trafostacionit tuaj të ri mirëpo është në planin investiv të KEDS-it për rritje të kapacitetit dhe duke pas parasysh që segmenti i linjës së TM ku ju keni propozuar kyçjen është në plan investiv për t'u demontuar, KEDS refuzon kërkesën tuaj për revidim të PEE paraprak, sepse vlerëson se zgjidhja e dhënë është e arsyeshme dhe e realizueshme pasi të bëhet rritja e kapaciteteve energetike në nivelin 10(20)kV.

Provë: Përgjigja e KEDS nr.8191 datë 21.08.2023



Me datë 12.10.2023 i pakënaqur me përgjigjen e KEDS-it, aplikuesi brenda afatit ligjor paraqet ankesë pranë DMK-së në ZRRE, duke kontestuar refuzimin e kërkesës së tij nga ana e KEDS-it.

Provë: Ankesa e aplikuesit datës 12.10.2023

Bordi i ZRRE, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS-it, ka vërejtur se:

Investitori **F.S, N.T.P Fontana-FS** ka aplikuar për pëlqim elektroenergjetik në KEDS për objektin afarist si dhe ka dorëzuar projektin elektrik. Sipas përmbledhjes së projektit vërtetohet se kërkesa është për fuqi maksimale të njëkohshme për një njësi prej Pm_{nj}=70 kW (sipas projektit elektrik). Me datë 26.05.2023 KEDS ka lëshuar PEE dhe Zgjidhjen teknike nr. 4630 ku ka theksuar se: duke marrë parasysh që dalja 10 kV "J03 Gërmova" me kod 61067003 nuk ka kapacitet për kyçjen trafostacionit tuaj të ri mirëpo është në planin investiv të KEDS-it për rritje të kapacitetit, ky Pëlqim Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike vlen në afat prej 365 ditësh kalendarike pasi ti bëhet rritja e kapaciteteve energjetike nga ana e KEDS. Pas këtij afati, nëse nuk ka Pranim Teknik, KEDS nuk është i obliguar të lëshoj Pëlqim me kushte të njëjta, fuqia e rezervuar për këtë PEE nuk do të garantohet.

Bazuar në të dhënat e Pëlqimit vërtetohet se zgjidhja teknike është lëshuar për veprimtarin afariste:

Objekt afarist, 1 njësi, Fuqia e transformatorit Sint=100 kVA ku fuqi maksimale të njëkohshme prej Pm_{nj}=70 kW (sipas projektit elektrik). Në PEE dhe ZT po ashtu janë përcaktuar edhe kushtet teknike të kyçjes si dhe mënyrës së furnizimit të aplikuesit. Furnizimi i objektit me energji elektrike të bëhet nga LP 10(20)kV dalja "Dalja Gërmoves me kod: 61067003" prej NS 35/10kV "Rrafshinë". Ekzekutimi i kyçjes së trafostacionit të ri të bëhet nga trafostacioni ekzistues TSSH 10/0.4 kV "Verban-te Sokoli" me kod 61067003044. Nga pika kyçëse e deri tek TS-i i ri të realizohet linja e re 10(20)kV për skaj rrugës publike sipas standardeve dhe projektit elektrik të aprovuar paraprakisht nga KEDS Departamenti i Investimeve. Trafostacioni i ri TS 10(20)/04 kV duhet të jetë me fuqi instaluese S_n=100 kVA i tipit "Trafo Shtyllë", me të gjitha pajisjet adekuate për këtë tip të trafostacionit dhe i ndërtuar në vend të përshtatshëm me mundësi të qasjes së përhershme....

Me datë 31.07.2023 Investitori **F.S**, ka parashtruar kërkesë në KEDS që të i bëhet revidimi i Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 4630 datë 26.05.2023. Aplikuesi në kërkesën e tij ka theksuar se përmes këtij pëlqimi me është lejuar kyçja në TSSH Nr:61067003044 me kabell nëntokësor në një gjatësi 550m deri të TSSH I Ri, andaj me mirëkuptim kërkojmë ndërrimin e pikës kyçjes pasi që rrjeti ajror 10 kV kalon shumë afër parcelës sonë. Parcela nga ku kërkojmë kyçjen në rrjetin 10kV të TSSH i Ri është prone e komunës andaj edhe kemi marr pëlqimin nga KK Viti për ndërtimin e L.P ajror në pronën e kësaj Komune. Me datë 21.08.2023 KEDS përmes një përgjigjeje e refuzon kërkesën e palës për ndryshim të kushteve teknike të dhëna me PEE dhe Zgjidhjen Teknike nr.4630 dt. 26.05.2023, konkretisht mënyrën e kyçjes së trafostacionit tuaj është refuzuar dhe mbesin në fuqi kushtet teknike të dhëna në Pëlqimin Elektroenergjetik nr.4630 dt. 26.05.2023. Në arsyetimin e përgjigjes është theksuar se duke pas parasysh që dalja 10 kV "J03 Gërmova" me kod 61067003 nuk ka kapacitet për kyçjen trafostacionit tuaj të ri mirëpo është në planin investiv të KEDS-it për rritje të kapacitetit dhe duke pas parasysh që segmenti i linjës së TM ku ju keni propozuar kyçjen është në plan investiv për t'u demontuar, KEDS refuzon kërkesën tuaj për revidim të PEE paraprak, sepse vlerëson se zgjidhja e dhënë është e arsyeshme dhe e realizueshme pasi të bëhet rritja e



kapaciteteve energetike në nivelin 10(20)kV. Bordi i ZRRE po ashtu vëren se KEDS ne përgjigjen e lëshuar nuk ka dhënë afatet se kur planifikohet qe te behet demontimi i kësaj pjese te linjës 10 kV. Aplikuesi F.S po ashtu ka ofruar lejen e lëshuar me datë 26.07.2023 me numër protokolli 09-320/04-26619 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, KK Viti, e ku thuhet se : Në bazë të kërkesës së Z. F.S nga Ferizaj, Komuna e Ferizajt, me nr. 09-320/04-26619, të dt. 12.07.2023, dhe pëlqimit parimor nga Njësia e Shërbimeve me Konsumator, KEDS, me nr.142 të datës 16.05.2023, per shtrirjen e rrjetit elektrik të tensionit të mesëm, si dhe vendosjen e dy shtyllave elektrike në fshatin Goshicë, Komuna e Vitisë, në hapësira publike afër shkollës së fshatit Goshicë, duke u bazuar në Rregulloren Komunale per Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba me nr. 01-110/05-1057, të datës 29.09.2022, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në Viti lëshon Leje per shtrirjen e rrjetit elektrik të tensionit të mesëm, si dhe vendosjen e dy shtyllave elektrike në fshatin Goshicë, Komuna e Vitisë, në hapësirë publike. Ne arsyetimin e lejes se lëshuar është evidentuar se aplikuesi ka bere pagesën e te gjitha taksave te parapara.

Bordi i ZRRE-së bazuar ne shqyrtimin e te gjithë dokumentacionit konstaton se aplikuesi F.S me rastin e aplikimit per kyçje ka vepruar konform nenit 8 te Rregullës per Kushtet e Përgjithshme te Furnizimit me Energji elektrike si dhe nenin 9 te Metodologjisë se Taksave te kyçjes se OSSH-së e ku thuhet se: “Çdo person fizik apo juridik, gjenerator/prodhues apo Konsumator Prodhues mund të aplikojë për kyçje të re apo modifikim të kyçjes ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, me qëllim të furnizimit me energji elektrike apo gjenerimit të energjisë elektrike”, kurse ne paragrafin 3 nen paragrafin 3.1 te këtij neni thuhet se: Përdoruesit ekzistues ose të ardhshëm të sistemit të shpërndarjes duhet të marrin ofertën e kyçjes për kyçje në sistemin e shpërndarjes nga OSSH kur ndërtojnë objekte të reja që duhet të lidhen me sistemin e shpërndarjes. Ne nenin 10 po ashtu janë te përcaktuara edhe fazat e procesit të kërkesës për kyçjes dhe shqyrtimi i kërkesës së aplikuesit për kyçje në sistemin e shpërndarjes si dhe per modifikimin e kyçjes s aktuale andaj edhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka respektuar kushtet e përcaktuara ne nenin 10.2 duke përgatitur ofertën per kyçje përkatësisht ka leshuar PEE dhe ZT nr. 4630 datë 26.05.2023 me te cilat janë te përcaktuara te gjitha kushtet teknike te cilat duhet te plotësohen para kyçjes përfshi edhe vendin ku do te behet kyçja, por qe Bordi i ZRRE vëren se ne PEE dhe ZT nr. 4630 datë 26.05.2023 është përcaktuar kushti qe: **duke marre parasysh që dalja 10 kV "J03 Gërmova" me kod 61067003 nuk ka kapacitet per kyçjen trafostacionit tuaj të ri mirëpo është ne planin investiv te KEDS-it për rritje te kapacitetit, ky Pëlqim Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike vlen ne afat prej 365 ditësh kalendarike pasi ti bëhet rritja e kapaciteteve energjetike nga ana e KEDS-it** duke mos përcaktuar saktë periudhën kohore se kur do te behet përforcimi. Ne nenin 11 te Metodologjisë se Taksave te kyçjes se OSSH-së qe definojnë parimet e dhe strukturën e taksave per kyçje përkatësisht nenin 11.1.5 thuhet se” *Kur kërkesa për kyçja të re e tejkalon kapacitetin e disponueshëm të rrjetit (përveç dispozitës të paraparë në nën-paragrafin 1.7 të këtij neni), atëherë Aplikuesi duhet të ngarkohet për kapacitetin e tij të nevojshëm për kyçje, përderisa OSSH bënë rritjen e kapacitetit të rrjetit” andaj ne kuptim te saj KEDS nuk duhet te përcaktoj kushtet te cilat janë ne shkelje te Metodologjisë se Taksave te kyçjes. Po ashtu bazuar ne planin zhvillimor dhe investiv te Operatorit te Sistemit te Shpërndarjes per periudhën 2023-2023 aprovuar nga ZRRE parashihet qe investimet ne këtë dalje te filloj ne në vitin 2027 dhe përfundon në vitin 2028 duke investuar në degët dytësore të kësaj dalje si dhe do të transferohet një TS në daljen Rrafshina.*



Bordi i ZRRE po ashtu është informuar nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatoreve se i njëjti ka mbajtur takim me përfaqësues të KEDS-it me qëllim që të behet rishqyrtimi i kërkesës së konsumatorit pasi që i njëjti edhe gjatë diskutimit në ZRRE ka potencuar se për një periudhë tranzitore i mjafton edhe fuqia e njëkohshme prej 30 kW si dhe është i gatshëm të paraqet dokument të noterit me të cilin merr përgjegjësin për zhvendosjen e linjës së ndërtuar nga ai nëse i lejohej të kyçet në pjesën e linjës e cila kalon afër objektit të tij pas zhvendosjes së kësaj linje nga KEDS. Bordit të ZRR-së po ashtu i është ofruar përgjigja e dërguar nga KEDS e ku thuhet se: Pas takimit që kemi pasur në lidhje me kërkesën tuaj për rishqyrtim të lëndës, konstatohet që dalja nuk ka kapacitet ndërsa sa i përket ndryshimit të pikës kyçëse të propozuar nga aplikuesi nuk mund të ndryshojmë pasi që pjesa e linjës ku ka kërkuar të kyçet kalon neper pronë private e cila është në planin investiv të KEDS-it që të demolohej. Si përfundim mbesin në fuqi kushtet e dhëna sipas pëlqimit elektroenergjetik dhe zgjidhje teknike të dhëna. Bordi i ZRRE-së vëren se KEDS nuk ka marrë për bazë lejen e lëshuar me datë 26.07.2023 me numër protokoll 09-320/04-26619 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, KK Viti, e ku thuhet se: Në bazë të kërkesës së Z. F.S nga Ferizaj, Komuna e Ferizajt, me nr. 09-320/04-26619, të dt. 12.07.2023, dhe pëlqimit parimor nga Njësia e Shërbimeve me Konsumator, KEDS, me nr.142 të datës 16.05.2023, për shtrirjen e rrjetit elektrik të tensionit të mesëm, si dhe vendosjen e dy shtyllave elektrike në fshatin Goshicë, Komuna e Vitisë, në hapësira publike afër shkollës së fshatit Goshicë, duke u bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha me nr. 01-110/05-1057, të datës 29.09.2022, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në Viti lëshon Leje për shtrirjen e rrjetit elektrik të tensionit të mesëm, si dhe vendosjen e dy shtyllave elektrike në fshatin Goshicë, Komuna e Vitisë, në hapësirë publike. Po ashtu në arsyetimin e lejes së lëshuar është evidentuar se aplikuesi ka bërë pagesën e të gjitha taksave të parapara.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Pëlqimi elektroenergjetik dhe Zgjidhja Teknike nr. 4630 datë 26.05.2023, përgjigja e KEDS nr.8191 datë 21.08.2023, lejen komunale me numër protokoll 09-320/04-26619 e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, KK Viti, Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Metodologjisë së taksave për kyçje të rrjetit të Shpërndarjes, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KEDS,
- Aplikuesit **F.S, N.T.P Fontana-FS** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.